

INTERVISTA E AMBASADORIT EUGEN WOLLFARTH DHËNË GAZETARES SONILA MEÇO NË “ABC NEWS”

25 prill 2012

Mirëmbërëma, z. Wollfarth!

Ambasadori Wollfarth: Mirëmbërëma! Ju falënderoj shumë për këtë ftesë në “ABC News”.

Është kënaqësi e jona t’ju kemi në këtë studio. Plotësojmë në këtë kuadër edhe prezencën e trojkës së famshme ndërkombëtare, në kuadër të një përpjekjeje që ka bërë ABC News për të kuptuar edhe më shumë misionin e ambasadorëve në Shqipëri, raportin që ata kanë vendosur me politikën dhe, tek e fundit, edhe popullaritetin që po fitojnë ambasadorët në Shqipëri.

Z. Ambasador, ju keni mbërritur në Shqipëri më 16 shtator 2010, në karrigen e kreut të Prezencës. Cilat nga rekordet më të rëndësishme që OSBE ka në misionin e saj, që nga mbrojtja e institucioneve kushtetuese, promovimi i demokracisë dhe të drejtave të njeriut ka përmirësuar Shqipëria gjatë këtij një viti e gjysmë të mandatit tuaj.

Ambasadori Wollfarth: Shqipëria ka bërë vërtet progres gjatë kësaj kohe të shkurtër. Shohim punë të vazhdueshme tani në parlament, në komisionin e posaçëm të reformës së Kodit Zgjedhor, si dhe pamë zgjedhjen shumë të rëndësishme të Avokatit të Popullit në fund të vitit të shkuar. Në kohën kur unë mbërrita, ngërçi politik vijonte ende dhe ndodhën disa ngjarje shumë të rëndësishme. Një ngjarje më e gëzueshme ishin zgjedhjet vendore, por gjithsesi një sfidë shumë e madhe. Pati shumë ngjarje dhe ishte interesante. Situata vazhdon të jetë interesante. Është një periudhë sfiduese, por gjithashtu me hapa përpara. Mua më pëlqen të jem këtu në Shqipëri, dhe ju përmendët miqtë, partnerët dhe kolegët e mi, Ambasadorin Amerikan dhe Kryetarin e Delegacionit të BE-së. Ne shkojmë shumë mirë me njëri-tjetrin dhe besoj se mendojmë në mënyrë të ngjashme dhe përiqemi ta çojmë Shqipërinë përpara.

Çka tregon që edhe vizioni i Brukselit, Washingtonit apo qendrave të tjera të vendimmarrjes konvergon, në këtë moment të rëndësishëm, për arritjet e Shqipërisë.

Ambasadori Wollfarth: Kjo është e vërtetë, dhe politikanët në veçanti, por dhe qytetarët, do të bëjnë mirë të dëgjonin këshillat që vijnë nga dy kryeqendrat që ju sapo përmendët. Por ata mund ta zgjerojnë horizontin e tyre dhe mund të dëgjojnë edhe vende të tjera si, Roma, Berlina, Haga, apo Strasburgu dhe Vjena, sepse edhe prej andej vijnë kontribute të rëndësishme për të ndihmuar Shqipërinë që të stabilizojë demokracinë dhe për funksionimin e institucioneve.

Ambasador Wollfarth, më 27 mars 1997 nisi misionin e OSBE-së në Shqipëri. 15 vite. Është vështirë të bëhet një përmbledhje e dinamikës së punës së OSBE-së, por më 27 mars të 2012 çfarë përgjigje mund t’i keni dhënë interesit të kolegëve tuaj nëse Shqipëria është një demokraci funksionale dhe a ka bërë progres në përputhje të pritshmërive që OSBE-ja ka për rolin e saj në Evropën Juglindore?

Ambasadori Wollfarth: Angazhimi që ndërmerr një vend kur bëhet anëtar i OSBE-së dhe përmbushja e standardeve është një detyrë komplekse. Nuk është përmbushur plotësisht gjatë këtyre 15 vjetëve, por është bërë përparim i pamasë. Kjo është arritur nga qeveri të ndryshme,

të drejtuara nga udhëheqës shumë të ndryshëm, nga kampe politike shumë të ndryshme. Kështu që historiku i përgjithshëm i vendit është shumë pozitiv. Institucionet janë më të qëndrueshme dhe janë bërë disa arritje. Disa nga këto mund të duken teknike për njerëzit, si për shembull prezantimi i shërbimit të provës – një zhvillim shumë i rëndësishëm në sistemin gjyqësor – policia kufitare tani po punon shumë më mirë, parlamenti është forcuar gjithashtu në kapacitetet e tij në sfond, që nuk është shumë e dukshme për njerëzit, kodet zgjedhore janë modifikuar disa herë duke përfshirë gjithashtu ekspertizën nga OSBE/ODIHR-i dhe partnerë të tjerë, dhe si rrjedhojë vendi është bërë në rritje gjithnjë e më i qëndrueshëm. Shqipëria sot funksionon shumë më mirë se në vitin 1997, kur Prezenca e OSBE-së në Shqipëri u ftua për të ndihmuar Shqipërinë si një shtet demokratik ende i ri për të përmbushur angazhimet e tij dhe standardet ndërkombëtare.

Pra Misioni i OSBE-në në Shqipëri në këto 15 vite mund të konsiderohet “possible” (i mundur) dhe jo “impossible” (i pamundur).

Ambasadori Wollfarth: Është një mision i mundur. Është një përzierje shumë interesante që karakterizon punën tonë të përditshme, jetën tonë të përditshme, kur puna është kaq interesante – duhet të gjesh ekuilibrin mes padurimit dhe durimit. Shqipëria ka bërë rrugë të gjatë. Përpara ka ende një copë udhë të gjatë, kur vjen puna për të përmbushur aspiratat e saj kombëtare, por dhe piketat më të vogla janë gjithashtu të rëndësishme dhe arrijtjet e bëra që nga nëntori i shkuar janë shumë domethënëse që tani. Kështu, në këtë drejtim, unë jam optimist, dhe ky është dhe qëndrimi im i parapëlqyer, të shoh anën pozitive.

Më vjen mirë për këtë gjë. Ju përmendët nëntorin, kur u arrit marrëveshja mes maxhorancës dhe opozitës. Dialogu ka funksionuar me dritëhijet e tij gjatë kësaj periudhe. Mendoni që ka qenë më lehtë për ta mbajtur këtë dialog apo është sfiduar fort nga vullneti i munguar i palëve për të çuar përpara axhendën integruese të Shqipërisë?

Ambasadori Wollfarth: Vendi më i mirë për shumicën e dialogut në këndvështrimin tim është parlamenti. Por nuk kufizohet vetëm tek parlamenti. Dialogu kalon edhe përmes medias ose, në rastin ideal, plotësohet gjithashtu nga takime të drejtpërdrejta – ndonjëherë pas dyeresh të mbyllura – midis udhëheqësve. Nuk ka kufizime për dialogun dhe kur sheh se si është ngritur sistemi kushtetues i Shqipërisë, që kërkon një shumicë 60% për ligje kyçe dhe për vendime shumë të rëndësishme, nevojitet dialog i mirë, dialog intensiv, dialog konstruktiv në mënyrë që të arrihet ky 60%. Unë e uroj shumë këtë dhe aspiratat kombëtare të Shqipërisë e kërkojnë këtë.

Ju folët për dialogë që janë bërë pas dyerve të mbyllura. Dialogu për reformën zgjedhore, diskutimi i komisionit në fjalë, si ju është dukur nga pikëpamja e transparencës dhe e gjithëpërfshirjes që ka qenë një kusht i rëndësishëm që OSBE ka vendosur për ndryshimin e Kodit?

Ambasadori Wollfarth: Ata po bëjnë një punë shumë të rëndësishme. Po bëjnë çmos për një transparencë sa më të mirë. I admiroj të gjithë anëtarët, duke nisur nga bashkëkryetarët për punën e tyre të palodhshme, si dhe ekspertët që punojnë aty nga pala shqiptare. Deri tani është një draft shumë i mirë. Nuk është ende i plotë. Shoh shumë vullnet të mirë, shumë frymë pozitive për të gjetur zgjidhje të mira, dhe procesi deri tani ka qenë gjithëpërfshirës. Disa ditë më parë u mbajt një takim i një grupi pune me ftesë zyrtare nga parlamenti. Takimi u hap nga Kryetarja e Kuvendit dhe u ndoq nga partitë e vogla dhe nga përfaqësues të

rëndësishëm të shoqërisë civile. Ata patën një përvojë dyditore të përbashkët me anëtarët e komisionit të posaçëm për reformën e kodit zgjedhor. Mendoj se ishte shumë i rëndësishëm dhe me sa di unë në disa raste dialogu vazhdon. Ka hapje, transparencë. Vendimet e rëndësishme nuk janë marrë ende dhe unë kam përshtypjen se raportimi i asaj që po ndodh në punën e komisionit të posaçëm nga ana e medias është gjithashtu shumë i mirë, kështu që transparenca është e sigurtuar.

Më 30 prill, pesë ditë nga sot, përfundon mandati zyrtar i komisionit të reformës zgjedhore. Ju vetë e pranuat që çështjet e rëndësishme ende nuk janë pasqyruar në draftin e Kodit. A mund të ketë një shtyrje të mundshme të mandatit, apo për pesë ditë mund të ndodhë mrekullia?

Ambasadori Wollfarth: Do të uroja që afati të arrihej, por në disa raste të mëparshme unë kam thënë që zgjidhjet cilësore, një draft shumë i mirë, janë më të rëndësishme se thjesht arritja e afatit. Më duhet ta përgëzoj komisionin e posaçëm. Kam përshtypjen e fortë se ata po bëjnë çmos për ta arritur afatin, por detyra është shumë e madhe dhe ata po punojnë në dijen e tyre më të mirë dhe deri në shterim fizik, sepse ata takohen për orë të tëra dhe ndonjëherë edhe natën. Edhe ata kanë nevojë të pushojnë. Nëse shkon pak më gjatë, mendoj se vendi, elektorati, votuesit në zgjedhjet e ardhshme do ta pranonin këtë. Dua të kujtoj në të njëjtën kohë që vendin e presin vendime të tjera të rëndësishme, kështu që koha për ta përgatitur Kodin Zgjedhor për vendimmarrje nuk është e pafund. Do të ishte mirë të rrinim afër 30 prillit ose në fillim të majit.

Kështu që mund të shkohet edhe në javët e para të majit në përmbylljen e mandatit të komisionit?

Ambasadori Wollfarth: Saktë. Kjo është të paktën realiste kur shoh zhvillimet. Në vend që të nxitohemi së tepërmi dhe ta përfundojmë punën e mirë të bërë deri tani në mënyrë të nxituar, unë do të thosha se është më mirë të marrim edhe disa ditë kohë.

Ju keni deklaruar që në nisjen e punës së këtij komisioni që është mirë që të kemi një reformë një vit përpara zgjedhjeve gati; të jetë e shëndetshme, të jetë në thelb me kompromis, me konsultime, e panxituar dhe natyrisht një produkt i cili do të vlejë. I përmbushi të gjitha këto kritere kjo punë e këtij komisioni?

Ambasadori Wollfarth: Po. Përgjigja shumë e thjeshtë për këtë është po. Ata po japin maksimumin e vullnetit të tyre dhe unë kam besimin se do të paraqesin një draft të mirë që do të sigurojë një platformë për zgjedhje shumë të mira në këtë vend, në zgjedhjet e përgjithshme të vitit të ardhshëm si dhe në zgjedhjet vendore të radhës.

Z. Ambasador, unë do t'i lejoj vetes të jem pak më pesimiste lidhur me punën e këtij komisioni. Jo të komisionit *per se*, por të faktit që unë kam ndjekur në kaq vite sa jam gazetarë punën e komisioneve sa herë është dashur të ndryshohet Kodi. Është gjetur gabimi te procedurat, te ligji, pavarësisht se sa herë që ka përfunduar punën një komision, palët kanë përgëzuar njëra-tjetrën, por sulmet nuk kanë munguar. Humbësit nuk e kanë njohur rezultatit. A mundet ky ndryshim, ky draft i përmirësuar dhe me këtë frymë ta zgjidhë njëherë e mirë problemin e njohjes në zgjedhjet shqiptare?

Ambasadori Wollfarth: Jam i prirur t'i mbroj bashkëkryetarët nga ky pesimizëm, por ju kuptoj shumë mirë Sonila. Kjo ka të bëjë pastaj me atë që politikanët do të bëjnë me këtë

proces. Do të varet nga fryma që ata sjellin në një fushatë zgjedhore, në ditën e votimit dhe më pas. Padyshim është shumë më e vështirë për atë që nuk i fiton zgjedhjet që t'i njohë ato. Të humbasësh është e vështirë, por kështu e ka politika. ODIHR-i e ka bërë të qartë në raportet e tij që shpesh varet nga vullneti politik dhe duhet të mbizotërojë vullneti i votuesit. Ajo që shoh në reformën e Kodit Zgjedhor që po zhvillon komisioni i posaçëm është një shërbim i posaçëm, por kjo sigurisht kërkon që në fund aktorët kryesorë politikë t'u përmbahen rregullave dhe të pranojnë dëshirën që zgjedhësit kanë shprehur në ditën e votimit, as më pak, as më shumë. Në këtë pikë, nga ajo që kemi parë të zhvillohet në vend deri më sot, mbetet shumë për të dëshiruar.

Shpresoj t'u jenë shuar veset kaq shpejt politikanëve shqiptarë. Por le të marrim pak disa çështje që janë më problematike të Kodit. Ende nuk është adresuar përfundimisht mënyra e organizimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Është një ndër rekomandimet më të rëndësishme që u bënë nga OSBE/ODIHR edhe pas zgjedhjeve të 2011-s. Ju vetë keni një formulë më të preferuar në lidhje me mënyrën e funksionimit nga disa propozimet që janë bërë tashmë në tryezë?

Ambasadori Wollfarth: Unë do të dëshiroja qartazi një Komision Qendror Zgjedhor të depolitizuar, sepse të ndihmohet të shohësh se çfarë votuesit duan në ditën e votimit është një punë teknike. Me komisione partiake kjo nuk është aq e lehtë. Nuk është e pamundur. Varet nga të gjitha nivelet e vullnetit politik. Edhe sistemi aktual mund të ofrojë një ekuilibër të mjaftueshëm për të arritur një rezultat të qartë dhe të saktë, por në fakt, në realitet keni parë zvarritje të numërimit, ndërlikime këtu, ndalimin e numërimit aty, të gjitha këto gjëra që nuk janë të nevojshme. Në një numërim të përpiktë, nuk ka rëndësi sa kohë duhet: rezultati, kur është i saktë, duhet të jetë i njëjtë. Më pas vjen dita e së vërtetës dhe kur zvarritet nuk ndihmon. Vetëm sa sjell shqetësim të votuesit. Ndoshta edhe një herë kërkon që të preket Kushtetuta dhe rregulloret e tjera që kërkojnë 60% për ta ndrequr këtë. Sistemi i mëparshëm parashikonte një përbërje të ndryshme të KQZ-së nga kjo që kemi tani. Duhet të punojmë me sistemin që shohim tani. Është një çështje e ndërlikuar. Misioni bëhet i pamundur vetëm kur një ambient i politizuar ndikon drejtpërdrejt mbi atë organ që duhet të punojë në mënyrë të pavarur, duke ndjekur rreptësisht rregullat.

Administrimi i votës njeh KQZ-në si organizmin më të lartë, për të vijuar në hierarki deri në komisionet e niveleve më të ulëta. Për shumë analistë, problemi nuk qëndron tek administrimi që bën Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, por te fakti që ky administrim, qoftë nga pikëpamja ligjore, qoftë nga pikëpamja e burimeve njerëzore është në duart e dy partive, të cilat e kanë shumë të lehtë të gjejnë konfliktin dhe të vështirë për të gjetur vullnetin për të bashkëpunuar. Mund të propozohet një mekanizëm për ta shmangur këtë lloj ndikimi apo për t'i bërë rezistencë, i parashikuar në Kodin Elektorale, dëshirës së politikës për të ndërhyrë në proces?

Ambasadori Wollfarth: Kjo varet nga personalitetet e të dy palëve; në komisioni dhe midis liderëve politikë, të cilët dërgojnë këto sinjale politike. Kjo varet në vullnetin politik për të dashur si persona dhe gjithashtu nga ana e autoriteteve zgjedhje transparente dhe të drejta, dhe jo ndërhyrje në numërimin e votave në mënyrën e duhur; si dhe në përcaktimin paraprak të rregullave sesi duhet të hidhet vota. Mund të bëhet. Nëse më lejoni një fjalë më të drejtpërdrejtë: kur të mos ketë më tundime për çfarëdolloj mashtrimi, atëherë qëllimi do të jetë arritur.

Numërimi elektronik është një mekanizëm që mund të bëhet efektiv për zgjedhjet e 2013-s? Ka një frikë se, pavarësisht se ka avantazhe teknologjike, është përsëri një mjet në duart e njerëzve dhe vullneteve, që, nëse mungojnë, mund të manipulojnë edhe teknologjinë.

Ambasadori Wollfarth: Midis qenieve njerëzore duhet të ndërtohet besim. Zgjedhjet varen gjithashtu nga besimi te njerëzit. Si votues ju dëshironi të besoni një kandidat ose një listë kandidatësh për të cilin ju votoni, dhe ju i besoni sistemit ose shpresoni që të mund t'i besoni sistemit që vota juaj do të numërohet në mënyrë korrekte. E njëjta është e vërtetë kur vota nuk numërohet me dorë, por me aparaturë, sepse aparatura është në duart e njerëzve. Kur ekziston besimi te njerëzit që bëjnë numërimin me dorë ose me makinë, atëherë gjithçka është në rregull. Kur besimi mungon që në fillim, atëherë ai besim nuk mund t'u delegohet aparaturave. Pra aparaturat mund të ndihmojnë, por nuk mund të zëvendësojnë besimin. Aparaturat mund të ndihmojnë shumë për të krijuar një ndjenjë më të mirë për demokracinë, sepse kur unë votoj dhe unë kam votuar shumë herë në jetën time, sigurisht unë jam një prej atyre të cilët duan të dinë se cili është rezultati, ku mbërritëm, cili fitoi, cila është përbërja e institucionit, qoftë parlamenti evropian apo parlamenti i vendit, Bundestagu apo parlamenti rajonal në rajonet e Gjermanisë. Sigurisht që njerëzit dëshirojnë ta dinë sa më shpejt si është rezultati, dhe kur kanë një rezultat të shpejtë dhe korrekt ndjehen më mirë, janë më të interesuar te demokracia, sepse pas pak javësh dita e zgjedhjeve mund të harrohet.

Mos harrojmë që kjo është e lidhur ngushtë edhe me procedura shumë të zgjata të daljes së rezultatit përfundimtar, që e kanë dëmtuar edhe më shumë procesin. Zgjedhjet e 2013-s do të kenë numërim elektronik?

Ambasadori Wollfarth: Është e mundur. Varet gjithashtu se sa shpejt mund të përfundojë procesi i Kodit Zgjedhor. Pasi, më vonë, në varësi të asaj që vendoset, duhet të fillojë procesi i tenderimit, vënia në punë e pajisjeve dhe trajnimi për përdorimin e tyre. Dhe, sa më i madh vendimi, aq kompleks është, dhe aq më shumë kohë do të duhet për zbatimin e tij. Shumë vende kanë provuar mënyra të ngjashme. Ato kanë filluar me një projekt pilot dhe e kanë zgjatur në kohë futjen e kësaj teknologjie. Duhet parë se çfarë do të vendoset përfundimisht. E rëndësishme është që të gjitha palët e përfshira të jenë dakord me sistemin dhe të mirëkuptohen që të kenë besim te pajisjet që mund të instalohen në kaq kohë sa ka mbetur. Tashmë po mbetet më pak se një vit dhe edhe procesi i blerjes është, gjithashtu, i ndërlikuar.

Në këtë kuadër, edhe vendosja e aparaturës për identifikimin e kartave të identitetit do të kërkonte të njëjtën ngarkesë? Është gjithaq komplekse? Si e shikoni faktin që komisioni vendosi që ta implementojë këtë zgjedhje?

Ambasadori Wollfarth: Nga informacioni që kam deri tani, kjo është disi më pak e komplikuar dhe mund të bëhet. Padyshim, mbetet një çështje madhore, sepse nevojitet i njëjti investim kohor. Po ashtu, duhen gjetur pajisjet, personat që do t'i përdorin e të tjera, por unë shoh arsye të mira për ta përdorur këtë sistem dhe mendoj se është e mundur.

Sot 26 parti parlamentare dhe jo parlamentare kanë paraqitur disa propozime për përmirësimin e Kodit elektoral. Shqetësimi më i madh i partive të vogla ka qenë edhe sistemi, mundësia e korrektimit të tij, sepse, sipas tyre, sistemi aktual ka probleme me barazinë e votës, madje shkohet deri në deklarime se është edhe antikushtetues në vetvete. Si e konsideroni ju sistemin aktual shqiptar dhe a ndani të njëjtin shqetësim me partitë e vogla?

Ambasadori Wollfarth: Kjo është një çështje shumë e rëndësishme, duke nisur që nga barazia e votës. Duhet gjetur një zgjidhje që do t'i jepte afërsisht të njëjtin numër mandatesh një numri të caktuar votash. Në të shkuarën, kjo ka qenë një sfidë e vërtetë. Partitë e vogla, me sa kam dijeni, duan gjithashtu një ndryshim të pragut për të hyrë në parlament. Kjo duhet shqyrtuar me kujdes. Përvoja e përgjithshme na mëson se është më mirë të mos ketë një numër tepër të lartë partish të vogla në parlament. Ka edhe nga ato vende ku kjo ndodh. Kjo çështje duhet të diskutohet mes kryetarëve të partive, duke përfshirë patjetër partitë e mëdha. Thënë kjo, do të doja të kujtoja gjithashtu edhe atë detyrë të rëndësishme që partitë dhe veçanërisht partitë e mëdha mund të përmbushin përmes diskutimeve të brendshme për të forcuar mendimet e një mase më të madhe njerëzish, gjë që është e rëndësishme në përgatitjen e vendimeve më të mëdha, sidomos kur nevojitet i shpeshquajhuri konsensus në vend, kur mbërrin te vendimet thelbësore e shumë komplekse, veçanërisht në procesin e integritimit evropian. Kjo është më e vështirë të bëhet kur ke një numër të lartë grupimesh të vogla, është më mirë me grupimet e mëdha. Por sërish, kjo varet nga ajo që duan shqiptarët. Ajo që me siguri nuk është e mirë në planin afatgjatë është ngurtësimi i një sistemi me parti të drejtura nga një njeri i vetëm dhe të përfaqësuara nga një njeri i vetëm në parlament. Kjo do të ishte tepër e copëzuar dhe do ta ndërlikonte vendimmarrjen. Në raste të tilla, është më mirë të gjendjen zgjidhje se si të integrohen ato në rryma më të mëdha, për të lehtësuar në mënyrë të arsyeshme procesin e vendimmarrjes.

Një tjetër çështje që ka prodhuar kriza në Shqipëri dhe që analizohet është dhe shkalla e përfaqësimit që sigurohet me këtë sistem që ne kemi. Kandidatët në Shqipëri nuk janë pjesë e garës elektorale. Ata zgjidhen dhe përfaqësohen në lista të mbyllura. Mendoni se kjo formë e përzgjedhur e konservon krizën?

Ambasadori Wollfarth: E kam ndjekur këtë diskutim. Nëse e krahasoni diskutimin e sotëm me atë të disa viteve më parë, me të vërtetë që ka ndryshuar. Para disa vitesh kishim një sistem të përzier, ku një pjesë e kandidatëve për deputetë zgjidhej përmes listave të caktuara nga partitë dhe një pjesë tjetër jashtë tyre. Edhe diskutimi që bëhej atëherë ishte pak a shumë i ngjashëm. Do të ishte e rekomandueshme për partitë që të dialogonin jo vetëm me anëtarët e tyre, por edhe me elektoratin e tyre të mundshëm rreth përbërjes së këtyre listave. Një gjë që do të dëshiroja ta theksoja teksa flas për listat është çështje e kuotave gjinore, pra, me qëllim që një e treta e këtyre listave të përbëhet prej grash, për më tepër në renditje që do t'i përfaqësonin ato numër të mjaftueshëm në Kuvend. Pra, në thelb, nuk ka asgjë të keqe nëse partitë caktojnë se kush duhet futur në këto lista për sa kohë që ato u përmbahen rregullave të vendosura. Edhe në këtë rast unë do të bëja thirrje për dialog me shoqërinë civile dhe me bazën e mundshme të mbështetësve me qëllim që të arrihen përpjesëtimet e duhura për sa i përket përbërjes së listave me synimin për një politikëbërje të suksesshme.

Reforma zgjedhore është një ndër 12 rekomandimet për marrjen e statusit. Në perceptimin tuaj dhe atë parashikim që mund të bëni në aq pak kohë sa ka mbetur deri në përfundim të mandatit, a mund t'i vëmë shenjën OK këtij rekomandimi si atij për Avokatin e Popullit, apo ligjet që kërkojnë shumicë të cilësuar?

Ambasadori Wollfarth: Në lidhje me Avokatin e Popullit sigurisht mund të vëmë shenjën OK. Nuk mund të zëvendësoj Komisionin Evropian, por mund të them nga ana e OSBE-së se procesi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit ishte një proces i mirë dhe u bë një përzgjedhje e mirë. Sigurisht, kjo ishte një nga kutitë, së cilës iu vu shenja OK, mirëpo mbeten edhe kuti të tjera bosh, dhe presim të shohim arritjen e rezultateve edhe në rastin e atyre kutive.

Reforma parlamentare është një tjetër kuti. Ka deklarata nga palët. Në perceptimin publik është krijuar ideja që u punua, por palët qëndruan fort në llogoret e tyre. Për ju, reforma parlamentare ose e ndryshimit të Rregullores së Kuvendit është përmbushur apo jo?

Ambasadori Wollfarth: Ka pasur progres edhe në lidhje me të, por nuk mund të quhet e përfunduar. Duhet të përfshijë edhe një rregullore konsensuale, dhe konsensusi në lidhje me këtë çështje nuk është arritur plotësisht. Mbeten të hapura edhe disa çështje të rëndësishme. Dialogu i mirë parlamentar disa herë përfshin edhe kundërvëniet për sa i përket përmbajtjes. Po ashtu, duhet të kemi baraspeshë edhe në përfaqësim, në kohën e fjalës. Mbeten, pra, edhe disa ndryshime për t'u bërë.

Mandati ka përfunduar.

Ambasadori Wollfarth: Mirëpo, mbeten çështje të hapura, të cilave u duhet dhënë zgjidhje.

Ndërkohë, z. Wollfarth, ne, përmbushjen e këtyre reformave, jo vetëm në përmirësimin e qeverisjes së shtetit ligjor në Shqipëri, por edhe në kuadër të aspiratës për marrjen e statusit të vendit kandidat, i shohim edhe në këtë perspektivë, pra në atë vlerësim që do ketë Komisioni Evropian. Ju vetë, si Ambasador i Prezencës së OSBE-së, jeni më optimist për marrjen e këtij statusi? I shihni rrethanat më në favor dhe vullnetin politik të konvergojë për këtë qëllim?

Ambasadori Wollfarth: Parlamenti po funksionon, është në punë. Ky është një hap i rëndësishëm. Folëm më sipër për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe ky ishte një hap tjetër i rëndësishëm, duke qenë se kemi të bëjmë me një institucion kushtetues. Optimizmi im është në rritje se ekzistojnë mundësi për të ecur përpara, megjithëse mbeten çështje të tjera të hapura. Gjithçka varet tërësisht nga fakti se sa shpejt por edhe me çfarë cilësie, kuptohet duke shpresuar që të jetë një cilësi e mirë, merren vendimet, pra, sa shpejt merren ato. Nevojitet edhe koha që Brukseli të mbledhë informacionin që i duhet, dhe përfundimi i asaj kohe po afrohet gjithnjë e më shpejt. Kështu që pikët që shënohen herët mund të çojnë në një rekomandim pozitiv. Ky është të paktën perceptimi im nga këndvështrimi i OSBE-së. Kur gjërat bëhen me vonesë, pikërisht pasi ka kaluar afati, nuk është se vlejnë shumë për të shënuar pikë. Kjo i ngjason një ndeshjeje futbollit, ku nuk mund të shënohen gola të tjerë pas fishkëllimës së fundit të gjyqtarit. Pastaj duhet të presësh deri sa të luhet ndeshja tjetër për të shënuar sërish.

Dhe në këtë përpjekje për të kapur rezultatin pozitiv brenda bilbililit është shtuar si rekomandim i 13-të edhe procesi i zgjedhjes së Presidentit?

Ambasadori Wollfarth: Sigurisht që ky është një proces i rëndësishëm. Bëhet fjalë për zgjedhjen nëpërmjet një procedure votimi, një sërë procedurash votimi në parlament, të numrit një të shtetit dhe respektimi i rregullave. Ndjekja e procedurave në mënyrë dinjitoze është patjetër ajo çka nevojitet. Ky proces po ndiqet nga afër nga shumë organizma. Edhe OSBE-ja do ta ndjekë nga afër për të parë se si do të zhvillohen procedurat. Unë thjesht bëj thirrje që të respektohet Kushtetuta në një frymë të mirë.

Këtë doja të pyesja edhe unë, por ju e bëtë saktësimin vetë, germa dhe fryma e Kushtetutës. Nuk janë të mjaftueshme për të pasur një besim brenda për brenda

Shqipërisë, por edhe tek faktori ndërkombëtar, sepse fjala gjithëpërfshirës, gjithëpërfshirës, gjithëpërfshirës, që përsëritet për disa muaj nga faktori ndërkombëtar ngjan si një puls alarmi, që kërkon të apelojë diku. Kujt i apelon?

Ambasadori Wollfarth: Politikanëve, sepse partitë duket se kanë një rol drejtues këtu në vend në propozimin e kandidatëve, por Presidenti i ardhshëm duhet të jetë mbi partitë. Megjithatë, Kushtetuta e parashikon dhe jep mundësinë e gjetjes së një ose edhe disa kandidatëve konsensualë që mund të konsiderohen. Tri raundet e para kërkojnë shumicë të cilësuar, që do të thotë se shumica qeverisëse dhe opozita do të duhet të binin dakord për të zgjedhur një kandidat në këto raste dhe sigurisht që kjo është ajo që preferohet, pasi Presidenti, numri një i vendit, do të duhet t'i përfaqësojë të gjithë shqiptarët. Kushtetuta aktuale lejon që, nëse kjo nuk arrihet, të zhvillohet një raund i katërt me shumicë të thjeshtë, që do të thotë më shumë se pesëdhjetë për qind të votave për zgjedhjen e Presidentit. Edhe kjo është e mundur dhe e mban vendin funksional dhe nuk e lë postin bosh. Preferohet të shihet një diskutim i mirë, një dialog i mirë dhe përpjekje për të gjetur kandidatë të mirë, që mund vërtet ta përmbushin këtë post kërkues, pra postin numër një të Republikës së Shqipërisë në mënyrë sa më dinjitoze. Unë jam i sigurt se kjo është e mundur dhe duhet bërë me energji e përmes një dialogu me përfshirjen e gjithë njerëzve të duhur.

Pra, mund të mos jetë domosdoshmërisht domein i politikës?

Ambasadori Wollfarth: Është e vërtetë, nuk është domosdoshmërisht domein i politikës.

Megjithatë ju u shprehët para pak ditësh, dje në mos gaboj, se prisni që politika të tregojë mençuri në këtë rast për të zgjedhur një figurë dinjitoze dhe që preferohet nga qytetarët në shumicë. Pra, kemi një trinom, Kushtetutë, qytetarë dhe politikë. Si mendoni që kjo politikë, kaq konfliktuale, do të mundte të lejonte atë frymë konsensuale apo të kompromisit të prevalonte në një zgjedhje, që tek e fundit është e parashikuar në gërmë në Kushtetutë?

Ambasadori Wollfarth: Ky është një proces zgjedhjeje në parlament dhe një mënyrë përfaqësuese e demokracisë. Unë jam i sigurt se mund të gjendet një zgjidhje me kusht që të ekzistojë vullneti i mirë për të identifikuar ose një kandidat të përbashkët ose disa kandidatë, që i plotësojnë kriteret dhe pastaj të zgjedhin një prej tyre. Sigurisht që nuk është e lehtë, por të kemi parasysh rekordet politike gjatë qëndrimit tim këtu. Klima ka qenë e komplikuar që para se të vija unë. Tani është disi më e mirë, por do të duhej një përpjekje nga të dyja kampet politike për të identifikuar një njeri të tillë. Nuk është e pamundur dhe kjo është ajo për të cilën unë do të bëja thirrje. Përndryshe, ekziston më së paku rreziku i dëmtimit të Presidentit nga diskutimet shpeshherë të ashpra, duke i bërë njerëzit që të mos shprehin më të gjendet dikush që mund ta ushtrojë këtë funksion të rëndësishëm shtetëror, sepse ai diskreditohet nga diskutimet shumë të ashpra para se ky person të fillojë punën. Unë do bëja thirrje për shmangien e konfrontimeve të tilla, sepse ato nuk janë konstruktive. Shqipëria aspiron të integrohet në BE, të arrijë standardet ndërkombëtare, të përmbushë angazhimet e veta, të forcojë institucionet dhe të ketë në të ardhmen një sistem më të fortë sigurish dhe garancish. Për këtë, juve ju duhet një President funksional, që luan këtë rol të rëndësishëm në koncertin e institucioneve kryesore të vendit.

Por si mund të arrihet në këtë konsensus, kur të dyja partitë bënë një ndryshim të Kushtetutës në vitin 2008 dhe zgjedhja e një Presidenti në raundin e katërt dhe të pestë

me 71 vota i lejon secilës nga forcat ose palët në parlament të prezantojë kandidatin e saj dhe dihet që palët kanë qëndrim refraktar kundrejt kandidatit opozitar?

Ambasadori Wollfarth: Kjo duhet parë. Raundi i pestë që parashikohet në Kushtetutë ofron edhe mundësinë që nëse nuk arrihet shumica e kërkuar, e cila, nëse nuk gaboj, është pesëdhjetë për qind plus një, 71 vota, të zhvillohen zgjedhje të reja brenda 45 ditësh, por ju nuk jeni ende në këtë fazë. Nuk shoh që Shqipëria të ketë ndonjë përfitim nga kjo. Tani është vërtet koha që të kërkohen kandidatë të mirë për një President të ardhshëm dinjitoz për vendin. Kjo është ajo çka meriton Shqipëria, çka meritojnë njerëzit, të paktën në këndvështrimin tim. Ndoshta e kam gabim, le të shohim.

Partia Demokratike është shprehur se kandidatura e ardhshme do të jetë nga figurat e rëndësishme të saj, me kontribute të rëndësishme politike, ndërsa opozita mendon se një kandidat për President i maxhorancës do të krijonte përqendrim pushteti dhe këtë e shikon si një shqetësim më të madh për të ardhmen e institucionit. A janë këto qëndrime të mençura politike si ato që kërkoni ju për zgjedhjen e Presidentit?

Ambasadori Wollfarth: Unë do të kisha dashur që të zhvilloheshin diskutime për identifikimin e një personaliteti që do të mund ta plotësonte boshllëkun. Ashtu siç është e strukturuar Kushtetuta për momentin, shumica mund ta zgjedhë kandidatin e saj në raundin e katërt, kështu që për opozitën do të ishte më mirë që të ishte e hapur për dialog dhe të ishte konstruktive duke bërë propozime të mira dhe duke përdorur një nga tre raundet e para dhe duke dërguar kështu një sinjal reagimi. Gjithashtu, ana tjetër, e kam fjalën për PD-në, do të duhej të ishte konstruktive në marrjen e këtyre sinjaleve, por varet nga personalitetet e përzgjedhura dhe të propozuara. Ky është një vendim që u takon shqiptarëve ta marrin, jo ndërkombëtarëve. Sigurisht që nuk do të jetë OSBE-ja ajo që do të vendosë se kush do të jetë President.

Politikanëve? Jo shqiptarëve.

Ambasadori Wollfarth: Sigurisht që u takon shqiptarëve, por në këtë rast është vërtet parlamenti ai që do të zgjedhë, pra janë politikanët.

Kemi një ambicie publike të shpallur nga lideri historik i së majtës, zoti Fatos Nano, i cili ka nisur një tur takimesh, me Ambasadorin Arvizu, me liderin e Lëvizjes Socialiste për Integrim, zotin Ilir Meta. A parashikohet në axhendë edhe një takim me ju, zoti Wollfarth?

Ambasadori Wollfarth: Jemi takuar në të kaluarën, gjatë një udhëtimiti, por ai ende nuk ka trokitur në derën time. Zoti Fatos Nano u shfaq në radarin tim në kohën kur merrja informacion përpara se të shkoja me punë në Kosovë, në vitin 2005. Dhe që nga ajo kohë më kujtohet se ka aftësi jashtëzakonisht të mira për të krijuar lidhje me njerëzit. Sigurisht që ishte një drejtues i fortë. U takon shqiptarëve të vendosin. Nuk jam shumë i sigurt. Duhet parë edhe Kushtetuta. Ka një nen që përshkruan kriteret për kandidatët – të ketë mbushur moshën 40 vjeç, të jetë i lindur shtetas shqiptar që nga lindja, me qëndrim jo më pak se 10 vjetët e fundit në Shqipëri. Nëse të gjitha këto kërkesa përmbushen, ai sigurisht që do të mund të jetë kandidat.

Roli i Presidentit në Shqipëri, i përcaktuar në Kushtetutën e Shqipërisë, mbetet i rëndësishëm për raportet me institucionet e drejtësisë dhe me institucionet e pavarura

në tërësi. Rekordin e Presidentit aktual që është ende në detyrë në këtë kuadër, si e cilësoni, si e vlerësoni?

Ambasadori Wollfarth: Ai është ende në detyrë. Kjo është një pyetje e rrezikshme për një diplomat. Por mund t'i përgjigjem me kënaqësi. Me Presidentin Topi kemi pasur një sërë takimesh, ku më pëlqen të veçoj ditën e zgjedhjeve të 8 majit 2011. Praktikisht, e kaluam gjithë ditën bashkë. Kemi zhvilluar shumë biseda. Mund të them për Presidentin Topi se është patriot, e njeh Kushtetutën dhe i përmbahet asaj; e pëlqen vendin e tij dhe është tifoz i sistemit të sigurive dhe garancive. Kushtetuta aktuale, me ndryshimet e vitit 2008, i kufizon mundësitë e Presidentit për të kontribuar në këtë sistem sigurish dhe garancish, çka do të ishte e nevojshme për ta ndihmuar vendin të ecë përpara. Ai vërtet ka dëshiruar një korrigjim, por kjo nuk është kompetencë e Presidentit. Kur bëhet fjalë për emërimin e gjyqtarëve, di nga diskutimet që kemi pasur bashkë, se Presidenti ka qenë i interesuar të gjente njerëz të aftë dhe gjykata pa vende bosh. Megjithatë, në disa raste kjo nuk ka qenë e mundur. Deri më tani, Gjykata Kushtetuese ka qenë shembull i bllokimit të plotësimit të vendeve bosh, çka nuk është mirë për vendin. Një tjetër çështje është Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Vendi vakant është plotësuar vetëm disa ditë më parë pas një vonese disi të gjatë. Të gjitha këto janë çështje tepër të rëndësishme për Presidentin, dhe unë mendoj se ai ka shërbyer në kohëra jo të lehta për vendin. Megjithatë, jam i sigurt, se historia do ta përmendë për mirë.

Është një moment në Këshillin e Lartë të Drejtësisë; një propozim që Presidenti i Republikës ka bërë për Nënkryetarin e këtij Këshilli. Ka një pretendim nga ana e maxhorancës në KLD se këtu ka një shkelje të Kushtetutës pasi është për zgjedhur një nga pjesëtarët e gjyqësorit në trupën e KLD-së. Pritet ky vendim i cili ende nuk është marrë. A ka një shqetësim OSBE-ja për këto përplasje midis maxhorancës dhe opozitës dhe institucionit të Presidentit në këtë propozim?

Ambasadori Wollfarth: Ne po e vëzhgojmë këtë nga afër dhe çdo zgjidhje që gjendet duhet të përmbushë kërkesat e Kushtetutës. Përndryshe kjo nuk do të kontribuonte në atë çfarë u nevojitet më së shumti qytetarëve – besim tek sistemi.

Ka pasur një propozim që meqenëse Presidenti do të jetë dhe më pak se dy muaj në detyrë, zgjedhja e Nënkryetarit të shtyhej për mandatin e ardhshëm të Presidentit meqenëse Nënkryetari është një post administrativ i cili zëvendëson Presidentin kur nuk është i pranishëm, dhe është një krah i rëndësishëm i tij brenda KLD-së.

Ambasadori Wollfarth: Sipas informacionit që kam, kjo, pra nëse procesi zgjat aq shumë, do të ishte kundër Kushtetutës. Nevojitet një përgjigje për këtë pyetje dhe plotësim i mangësive përpara se të zgjidhet Presidenti i ri.

Dhe procesi i Presidentit, edhe njëherë po ngulmoj z. Wollfarth, mënyra se si do të procedohet, dhe produkti që do të dalë prej tij, pa paragjykuar mënyrën me 84 apo 71 vota, a do të jetë një rekord për t'u vlerësuar në raportet e ardhshme të vetë OSBE-së, Bashkimit Evropian, dhe Komisionit Evropian?

Ambasadori Wollfarth: E keni fjalën për procesin? Jam i sigurt që po.

Teksa folëm për institucionet e pavarura, drejtësinë; është në objektivin e punës tuaj dhe monitorimi i reformës në drejtësi, gjendjen aktuale të këtij sistemi si e konsideroni. Edhe si një sfidë personale të OSBE-së për të përmirësuar sistemin në fjalë.

Ambasadori Wollfarth: Ka të bëjë pjesërisht me trajnimin e gjyqtarëve dhe gjithashtu të të tjerëve që punojnë me gjykatat, përfshirë edhe prokurorinë. Por një nga boshllëqet më të mëdha që më vjen në mendje janë vendet e lira në Gjykatën Kushtetuese. Unë do të dëshiroja një Gjykatë Kushtetuese plotësisht funksionale, që do të ndihmonte që sistemi të bëhej i drejtë në të gjitha nivelet, sepse ka herë pas here lajme shqetësuese rreth pavarësisë së gjykatësve dhe një ndikimi që ushtrohet jashtë kuadrit ligjor të gjyqtarëve. Kjo është shumë shqetësuese, për të cilën shteti dhe institucionet duhet të punojnë shumë.

Në raportin e OSBE-së në Vjenë, ju, ndër të tjera jeni shprehur se prisni që sistemi i drejtësisë në Shqipëri të jetë i përgjegjshëm, llogaridhënës, efikas, transparent. Ky rekord që sapo dhashë për këtë sistem, është problem i vetë sistemit, është problem i kulturës në përgjithësi apo i politikës? A i keni bërë dot një ndarje në përqindje se cili është faktori që ndikon më shumë te performanca?

Ambasadori Wollfarth: Do të thosha se përqindjet janë shumë matematikore. Ajo çka nevojitet është respektimi i plotë i rregullave dhe kujdesi për të mos u tunduar, mes të tjerash, nga paraja; marrja e vendimeve në kohën e duhur e jo duke i shtyrë, pra janë shumë rregulla. Të bëhesh dhe të jesh gjyqtar është një profesion shumë i ndërlikuar. Kërkon shumë, por ajo çka kërkon vërtet është pavarësia. Kemi parë gjithashtu raste ku imunitetet janë kthyer në pengesa. Dhe kjo është një çështje që duhet parë edhe në të ardhmen. Diskutimet publike rreth kësaj çështje kanë filluar tashmë dhe është diçka që duhet trajtuar në mënyrë që sistemi të bëhet i drejtë, sepse kjo është diçka që kërkohet kur kërkohet afrimin me strukturat e BE-së. Ka shumë punë për të bërë.

Nga e shikoni nisjen e punës për një reformë të thellë në drejtësi? Mision të kujt e shihni në vetvete?

Ambasadori Wollfarth: Duke qenë se Shqipëria është një vend sovran, do të thosha se nuk mund të aplikohet një sistem si ai i përdorur në Kosovë ku këtë detyrë e kryente UNMIK-u. Unë mendoj se shenja më e mirë do të ishte një qasje nga lart-poshtë, ja pse Gjykata Kushtetuese është kaq e rëndësishme, dhe pastaj të pastrohet sistemi. Hap pas hapi. Mund të bëhet.

Sa kjo ecuri e reformës në drejtësi, e performancës së sistemit të drejtësisë në tërësi, përkufizon marrëdhëniet e Shqipërisë me Evropën?

Ambasadori Wollfarth: Është një nga kushtet më të rëndësishme. Nëse sistemi i drejtësisë, pra një nga tri shtyllat e shtetit, nuk funksionon, atëherë nuk ka një shtet të ekuilibruar, dhe është e nevojshme që shteti të jetë i ekuilibruar në mënyrë që t'u shkohet më afër ëndrrave.

Një çështje e rëndësishme, e cila lidhet me drejtësinë është dhe hetimi për 21 janarin. Pak ditë më parë Ambasadori Arvizu deklaroi se do të ketë të dhëna të reja në lidhje me ecurinë e procesit dhe pikërisht zbardhja e plotë e kësaj çështje do të shërbejë dhe si nisje e një procesi shëruar nga ajo ditë e tmerrshme. Ju, a keni informacion lidhur me këtë moment të ri të fazës së hetimeve?

Ambasadori Wollfarth: Jo, nuk kam informacion shtesë. Nga këndvështrimi im, është shumë e rëndësishme që Prokurorja e Përgjithshme dhe skuadra e saj të punojnë në mënyrë të pavarur, me vërtetësi, në mënyrë korrekte, dhe në një fazë të mëvonshme kur procesi të hapet, me të gjithë transparencën e nevojshme për bërjen e çështjes. Çdo ndikim politik apo i çfarëdolloji tek çështja është i dëmshëm për sistemin. Ne duhet të shohim një sistem që funksionon siç duhet.

Qëndrimi tashmë i palëve në politikë lidhur me ngjarjet e 21 janarit është i njohur. Teksa presim përfundimin e hetimeve për vënien e drejtësisë në vend, në lidhje me këtë ngjarje, a është edhe 21 janari një rekomandim implicit, i pashprehur, në kuadër të marrje së statusit dhe rekordeve që arrin Shqipëria në raportet e organizmave ndërkombëtare?

Ambasadori Wollfarth: Është më mirë të pyetet Komisioni Evropian ose përfaqësuesit e tij. Unë mendoj se ata janë më të rëndësishëm. Kjo ishte vetëm një ngjarje njëditore, por ajo mund të vërtetojë se sistemi gjyqësor funksionon në mënyrë korrekte, që sistemi politik funksionon në mënyrë korrekte, dhe kjo do të thotë se ata nuk duhet të përfshihen, edhe pse pjesërisht demonstratat kishin një natyrë politike. Gjithashtu, shtylla tjetër duhet të bashkëpunojë dhe të mos pranojë ndikime. Kështu, sistemi duhet të funksionojë siç duhet, gjë që është më e rëndësishme sesa ngjarjet e asaj dite, asaj dite fatkeqe me katër viktima. Ky funksionim, do të thosha unë, përfshin një parlament funksional, funksionim më të mirë të gjyqësorit, një proces votimi të mirë për zgjedhjen e Presidentit, marrëdhënie paqësore me vendet kufitare, dhe kjo është një nga pluset e Shqipërisë, dhe zhvillim të mirë shoqëror. Kjo është ajo që nevojitet të shihet, dhe pastaj unë nuk shoh pengesa të tjera për vazhdimin përpara. Në aspektin gjyqësor, funksionimi ka të bëjë me zbatimin e ligjit dhe çështja e 21 janarit do të jetë një çështje shumë e rëndësishme, siç ishte çështja e Gërdecit, një proces shumë i gjatë për të cilin u deshën gati katër vjet për të arritur përfundimin e parë. Ishte një kohë shumë e gjatë. Si në zgjedhje, proceset e vërteta dhe më të shpejta janë produkte që mund t'i ofrojë shteti.

Dhe drejtësia në raport me politikën llogaritë i ka të hapura shpeshherë dhe bëhet problem dhe për perceptimin e qytetarëve edhe për çështjet e korrupsionit, por jo vetëm politika në këtë rast. Ju përmendët pak më parë dhe imunitetin e gjyqtarëve, duke shtuar dhe imunitetin e zyrtarëve të lartë. Keni propozuar pak kohë më parë që mund të adresohet çështja e imunitetit me prekjen e Kushtetutës. A i qëndroni të njëjtës ide?

Ambasadori Wollfarth: Po.

Dhe rekordet e Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit, a do të maten edhe me mënyrën se si do të adresohet çështja e imunitetit?

Ambasadori Wollfarth: Mund të jetë pjesë e asaj lufte kundër korrupsionit. Kjo varet. Shumë organizata ndërkombëtare dhe OJQ po vëzhgojnë rendimentin e Shqipërisë në lidhje me këtë çështje. Kjo varet pjesërisht tek vetë çështja, por edhe nga mënyra se si funksionojnë autoritetet e tjera.

Do dua t'ju citoj, z. Wollfarth. Ju deklaruat, edhe teksa dhatë raportin për vitin e kaluar për ecurinë e Shqipërisë në Vjenë se: Ky vit do të tregojë se ku duan ta çojnë

Shqipërinë liderët e saj politikë. Ju thoni se zgjedhja është e thjeshtë; dialog dhe reforma ose qëndrim në vend. Ku jemi, në mes të rrugës, në fillim, në fund?

Ambasadori Wollfarth: Faleminderit për citimin! Unë mendoj se në situatën aktuale ndodhemi pikërisht në këtë pikë. Shoh shumë më shumë dialog. Jo të gjitha pjesët e dialogut janë të lumtura, por dialogu po ndodh. Gjithashtu Parlamenti po funksionon dhe shikohet kontribut i rëndësishëm nga PS-ja, PD-ja, LSI-ja, dhe nga partitë e vogla. Kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme. Nëse Parlamenti do të ishte ende i bllokuar, do të ishim në një situatë tërësisht të ndryshme. Nuk do të kishim një Avokat Populli dhe mbase nuk do të kishim as reformat e tjera që të paktën kanë filluar dhe që janë në rrugë e sipër. Kjo është ajo që unë quaj dialog, ky është shkëmbimi, kjo është puna konstruktive, ky është hartimi i përbashkët në rastin e Komisionit e Posaçëm për Reformën e Kodit Zgjedhor. Pra po trajtohen disa detyra të mira dhe shpresoj që shumica, në mos të gjitha, të kenë një përfundim të mirë. Kjo është ajo që unë quaj dialog. Unë nuk quaj dialog atë që quhej dikur, kur në të njëjtën ditë dëgjohet e njëjta këngë nga të njëjtët këngëtarë. Ka të bëjë me gjetjes së zgjidhjeve të përbashkëta. Një emër tjetër për këtë do të ishte gjetja e kompromisit, sepse të dyja palët apo skuadrat sjellin pikat e rëndësishme nga listat e tyre të dëshirave. Është mjaft e dukshme që në një listë më të gjatë nuk mund të arrihen të gjitha pikat dhe duhen përcaktuar ato që janë më të dëshiruara, ku synon të shkosh, çfarë mund të japësh, çfarë mund të sakrifikosh, ku duhet të ngulmohet, dhe të gjesh një ekuilibër me homologun nga ana e kundërt. Pastaj, zgjidhja e përbashkët dhe një zgjidhje më përfshirëse mund të gjendet, sepse një nga mundësitë më të mëdha që ofron Kushtetuta dhe sistemi i Shqipërisë është që boshllëku të mbushet kur PD-ja dhe PS-ja të gjejnë zgjidhje pas një dialogu të saktë me botën e jashtme, jashtë sferës së brendshme të politikës, atëherë mund të gjenden zgjidhje të mira. Nëse dialogu, i cili duhet bërë në sferat e brendshme, nuk zgjerohet, duke përfshirë më shumë shoqërinë civile dhe duke diskutuar ligjet me industrinë, ndërmarrjet, dhe qytetarët që preken prej tyre, nuk arrihet të merren vendimet më të mira dhe ligjet kanë nevojë për përmirësime menjëherë pasi miratohen. Kjo është ajo që unë quaj dialog; ky proces që duhet të fillojë dhe duhet drejtuar nga Qeveria, Parlamenti, nga komisionet parlamentare, duke përfshirë shoqërinë civile dhe pjesët e interesuara të shoqërisë. Kjo po zhvillohet dhe kjo më bën optimist.

Pra, të njëjtët lider që ne kemi njohur si përgjegjës për mosmarrjen e statusit dy herë radhazi, janë bërë më të mirë sipas jush, tek të cilët mund të varim shpresat për një status që mund ta sigurojmë në dritën e këtij dialogu funksional.

Ambasadori Wollfarth: Pyetje e mirë për t'ua drejtuar votuesve. Është më e lehtë për mua t'i përgjigjem kësaj pyetjeje sepse unë nuk i zgjedh politikanët. Unë punoj me ata që janë tashmë në detyrë, qoftë me drejtuesin e Opozitës apo të Qeverisë, qoftë me një ministër apo kryetar bashkie. Të gjithë janë njësoj të mirëpritur, sepse tashmë ata janë zgjedhur. Nëse i meritojnë apo jo postet që kanë, kjo u takon plotësisht votuesve shqiptarë. Detyra ime dhe mënyra si e kuptoj profesionin tim është që duhet të punoj me ta, t'u ofrojmë atë për të cilën jemi ftuar – këshillim, që ata t'u sigurojnë një shërbim më të mirë qytetarëve dhe ta bëjnë Shqipërinë çdo ditë e më të suksesshme me autoritete që funksionojnë më mirë duke respektuar të gjitha rregullat dhe rregulloret dhe duke e vënë plotësisht në jetë një sistem ligjor relativisht të mirë. Kjo mbetet një detyrë komplekse, për të cilën po punojmë ditë pas dite bashkë me partnerët tanë.

Nuk mund të jetë kjo një interpretim që politika në Shqipëri është bërë më e sofistikuar për ta tejkaluar disi edhe faktorin ndërkombëtar?

Ambasadori Wollfarth: Doni të thonë që e anashkalojnë?

Jo vetëm. Për shembull po i referohem dhe rasteve konkrete. Trojka ka qenë aty sa herë ka pasur konflikte. Shpeshherë ka dialog në dukje por nuk ka progres në thelb në debatet midis palëve. Dhe këtu duket sikur është më e sofistikuar për t'i çuar një sinjal faktorit ndërkombëtar që në fakt dialogu funksionon, por ajo mençuria politike që ju apelonit pak ditë më parë, nuk është gjë tjetër veç një lojë politike.

Ambasadori Wollfarth: Unë mendoj, dhe tani po flas nga ana e ndërkombëtarëve, se ne ofrojmë këshilla, duke u përpjekur fort që të jemi të dobishëm dhe të gatshëm për të ndihmuar, por zgjidhja duhet gjetur dhe negociuar nga dhe midis partive shqiptare. Më duket normale që negociatat mund të jenë të ashpra në përmbajtje, dhe shpeshherë janë, veçanërisht kur bëhet fjalë për çështje të rëndësishme. Rrallë ndodh që opozita të lavdërojë qeverinë. Roli tipik i opozitës është që ta kritikojë në mënyrë konstruktive qeverinë dhe të ofrojë alternativa, duke u përpjekur që t'i përcjellë ato diç duhet. Këtë do të doja t'i ftoja të bënin. Kjo është normale. Ne nuk rrimë ulur me kronometër në dorë e të themi "Duhet të gjeni një zgjidhje brenda këtij afati kohor." Kjo u takon shqiptarëve. Në teori, ka kohë të mjaftueshme për t'i marrë të gjitha këto vendime. Por shumë prej vendimeve të ditëve të sotme kanë si shtysë axhendën ndërkombëtare. Më lejoni të përdor përsëri shembullin e integritimit evropian. Nëse të gjitha pikat plotësohen në janar, atëherë kjo do të vlente për vendimin që merret vitin e ardhshëm. Nëse plotësohen edhe më herët akoma, atëherë mund të jetë mirë për disa rekomandime këtë vit. Të gjitha këto duhen marrë parasysh, ashtu siç nuk duhet harruar se çdo humbje kohe ka një çmim ose të paktën një pasojë. Në këtë moment, nevojiten zgjidhje të hershme dhe një punë konstruktive. Megjithatë, kjo s'do të thotë se demokracia bëhet duke shtypur një buton, dhe se zgjidhjet mund të gjenden sa hap e mbyll sytë. Kjo kërkon diskutime të shëndosha, ide konstruktive dhe gatishmëri për të gjetur zgjidhje të përbashkëta. Përndryshe, në disa raste ligji është shumë i qartë. Nevojitet thjesht shumica dhe mund të merret vendimi. Kjo është demokracia.

Gjithsesi jemi në demokraci?

Ambasadori Wollfarth: Sigurisht.

Një moment të fundit, z. Ambasador. Ju keni qenë me misione edhe në vende të tjera të Ballkanit Perëndimor, vende që kanë problematika shumë më të mprehta se Shqipëria. E megjithatë nuk i keni shpëtuar dot shpeshherë përkufizimit tuaj në media sikur mbroni apo flisni shpeshherë në favor të njërës palë e kundër tjetrës. Kur e lexoni shtypin dhe shihni pretendime të tilla, çfarë mendoni?

Ambasadori Wollfarth: Mandati ynë në Shqipëri është një mandat për të gjithë shqiptarët dhe thelbi i tij është ndihma për institucionet dhe autoritet që ato t'u ofrojnë shërbime më të mira qytetarëve. Ata që kanë rëndësi me të vërtetë janë qytetarët. Nuk ka rëndësi nëse je me Partinë Demokratike, me Partinë Socialiste, LSI-në apo nga një minoritet, apo me asnjë parti. Shërbimet duhen ofruar njësoj, e njëjta drejtësi, i njëjti arsim, etj. Këtu është pak më e dukshme se në vende të tjera, por ekziston dhe në vende të tjera, kur përpiqen të të identifikojnë me një kamp apo me një tjetër. Mund të jetë e vërtetë ose jo. Unë do të thosha se kjo nuk vlen aspak, sepse mandati ynë është që të ndihmojnë demokracinë të jetë edhe më e suksesshme; të ndihmojmë që të drejtat e njeriut të respektohen në mënyrën më të mirë e më të plotë të mundshme; të ndihmojmë të shohim një shtet të plotë të së drejtës. Kjo fillon

edhe duke e reklamuar këtë gjë. Ndonjëherë është mirë të shohim Kushtetutën përpara se të nisim një diskutim. Disa pyetje mund ta kenë përgjigjen gati edhe pa pasur nevojë për diskutim. Nuk do të donim kurrë të shiheshim si mbështetës të një partie politike. Unë jam mbështetës i Shqipërisë, si një demokraci ende e re, me një hap të shpejtë zhvillimi. Do të doja të shihja një ritëm edhe më të shpejtë. Do të doja të shihja edhe më tepër progres. Shpresoj që e ardhmja të jetë aq e qëndrueshme sa të tërheqë edhe më shumë investitorë, sepse kjo është ajo çfarë u nevojitet më së shumti njerëzve. Ata kanë nevojë për arsim dhe punësim. Ky është edhe urimi im, dhe për këtë përpiqemi të kontribuojmë – për krijimin e një sistemi të mirë ligjor e funksional.

Dhe pyetja e fundit. Ishte më e lehtë apo më e vështirë se ç'e kishit perceptuar përpara 16 shtatorit 2010 puna në Shqipëri?

Ambasadori Wollfarth: Ishte sfiduese, por jo më e vështirë nga ç'e prisja. Sigurisht që disa ngjarje ishin të papritura. Unë prisja një detyrë sfiduese. Nuk u zhgënjeva. Mund të them në këtë fazë që nëse do më kërkonin përsëri të vija këtu, përsëri do të thosha "po". Shqipëria është një vend i mrekullueshëm dhe do të doja ta shihja të përmirësohet.

Z. Ambasador, teksa zhvillonim këtë intervistë, nuk i shpëtova dot tundimit për t'ju kërkuar një parashikim rezultati – jo për 2013-ën, por për ndeshjen sot Bayern-Real Madrid.

Ambasadori Wollfarth: Është pak e komplikuar. Bajerni ka fituar ndeshjen e kaluar, kështu që mendoj se janë disi në avantazh. Unë shpresoj që të bëjnë mjaftueshëm gola që të shkojnë në finale. Do të ishte shumë mirë, sepse do të ndodhte në Mynih, që do të thotë të luash në stadiumin tënd.

Në fakt, rezultati për momentin është 2:1 për Realin. Unë po ju lë të lirë, sepse mund të jeni një ogur fatsjellës për skuadrën e Bajernit. Ju falënderoj z. Ambasador për prezencën. Është kënaqësi rikthimi juaj në ABC News. Keni qenë për të vizituar në krye të herës kur këto studio përfunduan, për të parë një media të re që po lindte. Më vjen mirë që në këtë udhëtim tonin dhe në këtë pjekuri tonën ju iu përgjigjët interesit të stafit gazetaresk. [Bajerni i Mynihut fitoi pas një loje dramatike dhe gjuajtjeve me penalti].

Ambasadori Wollfarth: Kënaqësia është imja. Erdha me interes dhe ju falënderoj për ftesën.

Të nderuar teleshikues, sapo ndoqët këtë intervistë ekskluzive me Kreun e Prezencës së Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, z. Eugen Wollfarth. Sigurisht që do të keni mundësinë që ta ndiqni edhe të ritransmetuar përgjatë orëve në vijim. Ju falënderoj të gjithëve për vëmendjen! Bashkë, mirupafshim!

Fund